

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi në çështjen penale ndaj të akuzuarit Q.L. me vendbanim në fshatin ... K. ..., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.Nr.621/2017 të datës 18.04.2017, të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 25.09.2018 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Q.L., nga i ati Sh., e ëma Z. e lindur B. i lindur ... në fshatin ... K. ... me vendbanim në fsh. ... K. ..., ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në autolarje, i martuar, i gjendjes ekonomike të mesme, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 04.04. 2017, rreth orës 19:10 minuta në Gjilan në rrugën ‘‘Medllin Ollbrajt’’, i pandehurit nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që duke drejtuar automjetin e markës ‘‘VW Golf 1HXO’’, me tabela ..., ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 55.1-A dhe B të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor të Republikës së Kosovës –shoferi duhet të ngas mjetin me shpejtësi që nuk pengon lëvizjen e mjeteve të tjera dhe të mbaj distancë të nevojshme në mes mjetit përpara që është e nevojshme për t’iu shmangur goditjes së mjetit nëse frenon apo ndalet, ashtu që me të arritur afër sallonit ‘‘Nota Brillant’’, me pjesën e parë e godet në pjesën e pasme automjetin e markës ‘‘VW- Pasat’’ me tabela ..., të cilin e drejtonte i dëmtuari K.Y., i cili nga fuqia e goditjes me pjesën e parë e godet në pjesën e pasme automjetin e markës ‘‘VW Golf II’’, me tabela ..., të cilën e drejtonte e dëmtuara V.V., të cilët ishin ndalur, sepse kishin hasur në kolonë të automjeteve, me ç’rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore, ku lëndime të lehta trupore pëson K.Y., i cili kërkon ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan-Emergjencë.

Me çka ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 73, 74 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin:

E G J Y K O N

Të pandehurit Q.L., i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro), të cilën gjobë do ta paguaj në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20.00 € (njëzet euro) ndërsa nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20.00 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil. Obligohet i akuzuari që të paguajë paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Të akuzuarit i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 18.04.2017, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.621/2017, kundër të pandehurit Q.L., nga fsh. ... K. ..., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s. Në shqyrtimin fillestar në të cilin ishin prezent Prokurori i Shtetit Shefik Memeti, i pandehuri Q.L., ndërsa nuk ishin prezent të dëmtuarit K.Y. dhe V.V., në të cilën seancë i pandehuri deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj veprës penale.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit Q.L., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri Q.L., ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s dhe nenin 55,1-A dhe B të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor të Kosovës, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin Q.L., për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s dhe nenin 55,1-A dhe B të ligjit mbi trafikun rrugor të Kosovës. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

Në nenin 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, vepra penale Rrezikim i trafikut publik konsiderohet:

1. Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që të pandehurit Q.L., si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti ndien shumë keqardhje për rastin, dhe ka premtuar që në të ardhmen do të ketë më tepër kujdes gjatë drejtimit të automjetit dhe nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka konsideruar dëmin e shkaktuar dhe lëndimet trupore të dëmtuarve.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit Q.L., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit. Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

9. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit Q.L., gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPRK-së, e obligoi ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe kompensimin për viktimat të krimit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.377/2017 - Më datë 25.09.2018

Sekretarja Juridike
Igballe Azemi

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate